

PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË INTERIERI DHE DIZAJN _SHQIPTARË BRENDË VENDIT, KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËT ME ORIGINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT DHE MALI I ZI

Kandidatët duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës. Ose kopje të saj të njehsuar me origjinalin. Të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin ose në mungesë të saj të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim
- b) Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2
- c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1
- d) Kopjen e dokumentit të identifikimit
- e) Dy fotografi personale
- f) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, vetëm për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë

Shënim:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.